

## TRANZITI

Për qëllim të nenit 182 deri 233<sup>1</sup>:

- a) “Mjet transporti” do të thotë: mjete, në veçanti:
  - i) çdo mjet rrugor, rimorkio ose gjysëm-rimorkio, çdo vagon treni ose vagon mallrash,
  - ii) çdo varkë ose anije,
  - iii) çdo mjet fluturimi
  - iv) çdo kontenier në kuptim të nenit 2(9)(g);
- b) “Zyrë nisje” do të thotë: zyra doganore ku fillon operacioni i tranzitit;
- c) “Zyrë destinacioni” do të thotë: zyra doganore ku mallrat e vëna nën regjimin e tranzitit duhet të paraqiten për të përfunduar operacionin e tranzitit;
- d) “Zyra e garancisë” do të thotë: zyra doganore ku është dhënë garancia globale.

### Neni 182

Në përputhje me pjesën IV, kreu 2, seksioni 3B të Kodit, ky kre përcakton dispozitat për zbatimin e regjimit të tranzitit.

### Neni 183

1. Në përputhje me nenin 114 (1) (b) të Kodit, mallrat shqiptare lëvizin nën regjimin e tranzitit në rastet e mëposhtme:

- a) kur rimbursimi ose shuarja e detyrimeve doganore kushtëzohet nga rieksporimi i tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose nga vendosja në magazinim doganor, zonë të lirë ose magazinë doganore të lirë ose nën një regjim doganor të ndryshëm nga vendosja në qarkullim të lire; ose
- b) kur ato janë vendosur në qarkullim të lirë nën regjimin e përpunimit aktiv me rimbursim, me synim që të eksportohen më tej në trajtën e produkteve kompensuese dhe për të cilat, në përputhje me nenin 149 të Kodit, mund të paraqitet një kërkesë për rimbursim dhe personi i interesuar synon të depozitojë një kërkesë të tillë.

2. Mallrat e referuara në paragrafin 1, të cilat nuk kanë dalë nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, trajtohen si mallra shqiptare, me kusht që të dëshmohet që deklarata e eksportit dhe formalitetet e tjera doganore të nevojshme në mënyrë që mallrat të largohen nga territori në fjalë, dhe çdo efekt i këtyre formaliteteve është anuluar.

### Neni 184

1. Gjithë mallrat të cilat duhet të lëvizin nën regjimin e tranzitit janë objekt i një deklarate T1, që bëhet në përputhje me këtë Seksion. Deklarata T1 nënkupton një deklaratë në një formular që i korrespondon modeleve të pasqyruara në Anekset 9 dhe 10 dhe të përdorur sipas shënimeve të parashikuara në Anekset 12 dhe 13.

2. Listë ngarkesat, të cilat bazohen në modelet e Aneksit 17, mund të përdoren në përputhje me këto dispozita zbatuese si pjesa përshkruese e deklaratës së tranzitit. Ky përdorim nuk ndikon mbi detyrimet lidhur me formalitetet përkatëse të një regjimi dërgimi/eksporti, ose lidhur me formularët e përdorur për këto formalitete.

### Neni 185

Listë ngarkesa përmban:

- a) titullin: “Listë ngarkese”;
- b) një kuti me përmasa 70 x 55 mm, të ndarë në një pjesë të sipërme me përmasa 70 x 15 mm ku shënohet simboli “T”, i ndjekur nga një prej shënimeve “T1” ose “T1 bis” dhe një pjesë të poshtme me përmasa 70 x 40 mm për përdorim zyrtar;
- c) kolonat, të renditura dhe të titulluara si vijon:
  - i) numri rendor,

---

<sup>1</sup> Shiko nenin 2(6). Ky tekst është rishkruar këtu për lehtësi përdorimi të termave të përkufizuar.

- ii) marka, numra, sasia e lloji i kolive, përshkrimi i mallrave,
  - iii) vendi i dërgimit/eksportimit,
  - iv) pesha bruto (në kg),
  - v) vetëm për përdorim zyrtar.
- d) Gjerësia e kolonave përshtatet sipas nevojës. Megjithatë, gjerësia e kolonës së titulluar “*Vetëm për përdorim zyrtar*” nuk duhet të jetë më e vogël se 30 mm. Mund të përdoren gjithashtu edhe hapësira të tjera prej atyre të cilave i referohet (a), (b) dhe (c) më sipër.

*Neni 186*

1. Si listë ngarkesë mund të përdoret vetëm faja ballore e fletës.
2. Çdo element i pasqyruar në listë ngarkesë duhet të paraprihet nga numri rendor.
3. Çdo element ndiqet, kur është rasti, nga referime specifike të cilat parashikohen nga legjislacioni në fuqi, dokumentat e paraqitura dhe çertifikatat apo autorizimet.
4. Pas shënimit të fundit vendoset një vijë horizontale dhe hapësirat e papërdorura që mbeten mund të kryqëzohen në mënyrë që të mos lihet mundësi për shtesa të mëtejshme.

*Neni 187*

1. Autoritetet doganore mund të lejojnë edhe përdorimin e listë ngarkesave të cilat nuk përmbushin të gjitha kërkesat. Megjithatë, përmasat dhe hapësira e përdorur për përdorim nga autoritetet doganore nuk duhet të ndryshojë.

Përdorimi i kësaj liste lejohe vetëm atëherë kur ato:

- b) përgatiten nga shoqëri, regjistrat e të cilave bazohen në një sistem të integruar elektronik ose automatik të përpunimit të të dhënave;
  - c) janë përgatitur dhe plotësuar në mënyrë të tillë që mund të përdoren pa vështirësi nga autoritetet doganore;
  - d) për çdo artikull përmbajnë sasinë, llojin, markat dhe numrat e kolive, përshkrimin e mallrave, vendin e dërgimit/eksportit dhe peshën bruto në kg.
2. Autoritetet doganore mund të lejojnë shoqëritë, regjistrat e të cilave bazohen në një sistem përpunimi të dhënash elektronik ose automatik, dhe të cilat lejohen sipas paragrafeve 1 dhe 2 të përdorin listë ngarkesa të një lloji të veçantë, të përdorin këto lista për operacione tranziti që përfshijnë vetëm një lloj malli kur një lehtësi e tillë bëhet e nevojshme nga programet kompjuterike të shoqërisë në fjalë.

*Neni 188*

1. Kur përgjegjësi kryesor përdor listë ngarkesa për një dërgesë që përmban dy ose më shumë lloje mallrash, kutitë 15 “vendi i dërgimit/eksportit”, 33 “Kodi tarifor i mallrave”, 35 “Pesha bruto (kg)”, 38 “Pesha neto (kg)” dhe kur është e nevojshme, 44 “Dokumente plotësuese, dokumente të lëshuara, çertifikata dhe autorizime” të formularit u vihet kryq dhe kutia 31 “Kolitë dhe përshkrimi i mallrave” e atij formulari nuk përdoret për të treguar markat dhe numrat, numrin dhe llojin e kolive dhe përshkrimin e mallrave. Kur përdoren listë ngarkesat, nuk përdoren formularë plotësues.
2. Listë ngarkesa lëshohet në të njëjtin numër kopjesh si edhe deklarata T1 me të cilën ajo ka të bëjë.
3. Kur regjistrohet deklarata, listë ngarkesa duhet të mbajë të njëjtin numër regjistrimi si edhe deklarata T1 me të cilën ajo ka të bëjë. Numri shkruhet ose nëpërmjet një vule që përmban në vetvete emrin e zyrës nisëse, ose me dorë. Në rastin e fundit duhet të shoqërohet nga vula zyrtare e zyrës nisëse. Nënshkrimi i një zyrtari të kësaj zyre është fakultativ.
4. Kur një deklaratë e vetme T1 shoqërohet nga dy ose më shumë listë ngarkesa, çdo numër duhet të ketë edhe numrin rendor të vendosur nga përgjegjësi kryesor. Numri i listë ngarkesës duhet të tregohet në kutinë 4 të deklaratës T1 të titulluar “Listë ngarkesat”.
5. Një deklaratë e bërë në një formular të Dokumentit Administrativ të Vetëm që mban shenjën T1 në nëndarjen e djathtë të kutisë 1 dhe që shoqërohet nga një ose më shumë listë ngarkesa duhet të trajtohet si një deklaratë tranziti.

*Neni 189*

1. Kur mallrat qarkullojnë nën një regjim tranziti, përgjegjësi kryesor shënon simbolin "T1" në nëndarjen e djathtë të kutisë 1 të formularit të përdorur. Kur përdoren formularë plotësues, përgjegjësi kryesor duhet të shënojë simbolin "T1 bis" në nëndarjen e djathtë të kutisë së parë të formularit të përdorur.
2. Deklarata T1 duhet të nënshkruhet nga përgjegjësi kryesor dhe kopjet 1, 4, 5 dhe 7 të saj duhet paraqitet në zyrën nisëse.
3. Kur regjimi i tranzitit ndjek një regjim tjetër doganor, ky regjim duhet të përmendet në deklaratën T1, ose në dokumentat doganore përkatëse.

*Neni 190*

1. I njëjti mjet transporti mund të përdoret si për ngarkimin e mallrave pranë më shumë se një zyre nisëse, ashtu edhe për shkarkimin e mallrave në më shumë se një zyrë destinacioni.
2. Çdo deklaratë T1 përfshin vetëm mallrat e ngarkuar apo për t'u ngarkuar në një mjet transporti të vetëm për transportim nga një zyrë nisëse në një zyrë destinacioni. Për qëllim të fjalisë së parë, mjetet e mëposhtme do të merren si pjesë përbërëse të një mjeti transporti të vetëm, me kusht që të transportojnë mallra të cilat përbëjnë një dërgesë të vetme:
  - a) një automjet rrugor i shoqëruar nga rimorkioja/rimorkiot ose gjysmë rimorkioja/rimorkiot e tij;
  - b) një varg vagonash hekurudhorë;
  - c) mjete lundruar që formojnë një karvan të vetëm;
  - d) kontenierë ngarkuar në një mjet transporti në kuptim të këtij neni.

*Neni 191*

1. Zyra nisëse pranon dhe regjistron deklaratën T1, cakton afatin brenda të cilit mallrat duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit dhe merr masat e nevojshme për identifikim nëse e konsideron të nevojshme një gjë të tillë.
2. Zyra nisëse shënon hollësitat e nevojshme në deklaratën T1, mban kopjen 1 të saj dhe i kthen përgjegjësit kryesor ose përfaqësuesit të tij kopjet e tjera.
3. Mjetet e transportit nën regjimin e tranzitit nuk lejohen të largohen nga zyra doganore nisëse pa autorizim nga autoritetet doganore.
4. Në rastet kur mallrat për t'u tranzituar paraqesin rrezik të lartë për mashtrime, apo në çdo rast kur autoritetet doganore e konsiderojnë të nevojshme, zyra nisëse mund të caktojë një itinerar për dërgesën. Itinerari, me kërkesë të përgjegjësit kryesor, mund të ndryshohet vetëm nga autoritetet doganore të zyrës nisëse dhe kjo kërkesë duhet të depozitohet brenda afatit kohor të caktuar për këtë qëllim. Autoritetet doganore marrin masat e nevojshme për trajtimin e çdo shkeljeje apo parregullsie dhe vendosjen e gjobave të duhura në përputhje me nenin 260 të Kodit.
5. Në rastet e forcave madhore, mjeti i transportit mund të devijojë nga itinerari i përcaktuar. Dërgesa dhe dokumenti T1 paraqiten pranë autoriteteve doganore më të afërta pa vonesë. Autoritetet doganore informojnë menjëherë zyrën nisëse përse i përket devijimit dhe regjistron hollësitat përkatëse në dokumentin T1.

*Neni 192*

1. Si rregull i përgjithshëm, identifikimi i mallrave sigurohet nëpërmjet plumbosjes.
2. Mund të plumboset:
  - a) hapësira që përmban mallrat, kur mjeti i transportit në bazë të rregullave të tjera, përveç legjislacionit doganor miratohet apo njihet nga zyra nisëse si i përshtatshëm për plumbosje;
  - b) çdo koli e veçantë, në raste të tjera.
3. Mjetet e transportit konsiderohen të përshtatshme për plumbosje nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) mund të plumbosen thjesht dhe me efikasitet;
  - b) janë ndërtuar në mënyrë të tillë që përjashtohet mundësia e zhvendosjes ose vendosjes së mallrave pa lënë shenja të qarta të manipulimit apo pa thyer plumbin;
  - c) nuk përmbajnë hapësira ku mund të fshihen mallrat; dhe
  - d) në hapësirat e rezervuara për vendosjen e ngarkesës autoritetet doganore mund të hyjnë

lehtësisht për kontroll.

4. Zyra nisëse mund të mos kryejë plumbosjen në rast se, duke pasur parasysh masa të tjera të mundshme identifikimi, përshkrimi i mallrave në dokumentin T1 ose në dokumentet plotësuese i bën ata lehtësisht të identifikueshëm.

*Neni 193*

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të vendosë që tranziti me kamionë, rimorkio ose kontenierë të lejohet vetëm në qoftë se këto mjete janë miratuar për transport ndërkombëtar të mallrave të plumbosura nga dogana, dhe që janë në kushte të mira.

*Neni 194*

1. Mallrat transportohen të shoqëruara nga kopjet 4, 5 dhe 7 e dokumentit T1 të cilat i janë dhënë përgjegjësit kryesor ose përfaqësuesit të tij nga zyra nisëse pas formaliteteve të kryera aty.

2. Drejtuesi i mjetit të transportit nën regjimin e tranzitit duhet të mbajë me vete kopjet e dokumentit T1 dhe t'i paraqesë ato kundrejt kërkesës së autoriteteve doganore apo ndonjë autoriteti tjetër publik kur kjo parashikohet nga legjislacionin në fuqi.

*Neni 195*

Në rastet kur mallrat ngarkohen apo shkarkohen në prani të autoriteteve doganore të ndërmjetme kopjet e dokumentit T1 paraqiten pranë këtyre autoriteteve.

*Neni 196*

Mallrat e përshkruara në dokumentin T1 mund të transbordohen në një mjet tjetër transporti nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore që veprojnë në territorin ku bëhet ky transbordim pa qenë nevoja të bëhet një deklaratë e re. Në këtë rast, autoritetet kompetente regjistrojnë hollësitat e nevojshme në dokumentin T1.

*Neni 197*

1. Në rast se gjatë transportimit për arsye që nuk varen nga transportuesi, thyhet plumbosja, ky i fundit pa vonesë duhet të kërkojë mbajtjen e një proces verbali nga ana e autoritetit doganor më të afërt, pa rënë ndesh me nenin 280 të Kodit lidhur me procedurat e ndjekjes penale. Autoriteti doganor kompetent vendos në rast se është e mundur, vula të reja.

2. Në rast aksidenti që kërkon transbordimin e mallit në një mjet tjetër transporti, ky veprim duhet të bëhet nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore të cilat janë kompetente në territorin ku do të bëhet transbordimi.

3. Në rast rreziku të menjëhershëm dhe real i cili kërkon shkarkimin në çast të të gjithë apo një pjese të ngarkesës, transportuesi mund të veprojë me iniciativën e tij. Këtë rrethanë, ai duhet ta regjistrojë në dokumentin T1. Në të tilla raste zbatohet paragrafi 1 i këtij neni.

4. Në rast se, si rrjedhojë e aksidenteve apo incidenteve të tjera të cilat lindin gjatë transportit, transportuesi nuk mund të respektojë afatin kohor të caktuar brenda të cilit mallrat duhet të paraqiten në zyrën e destinacionit, ai duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetet doganore të cilave i referohet paragrafi 1. Këto autoritete më pas regjistrojnë hollësitat përkatëse në dokumentin T1.

*Neni 198*

1. Mallrat dhe dokumenti T1 paraqiten në zyrën doganore të destinacionit.

2. Drejtuesit e mjeteve të transportit nën regjimin e tranzitit duhet të paraqesin pa vonesë deklaratën e tranzitit së bashku me mallrat pranë zyrës doganore të destinacionit. Atyre nuk u lejohet të bëjnë ndalesa gjatë tranzitimit, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për arsye sigurie apo të miratuara nga autoritetet doganore apo ndalesave që kryhen për t'iu përgjigjur kërkesës së ndonjë autoriteti publik në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Zyra e destinacionit në kopjen 4 dhe 5 të dokumentit T1 duhet të regjistrojë detajet e kontrollit të kryer dhe brenda 10 ditëve i dërgon zyrës nisëse kopjen 5, duke mbajtur kopjen tjetër.

4. Sa herë që autoritetet doganore e konsiderojnë të nevojshme, zyra e destinacionit mund të ndryshohet me kërkesën e përgjegjësit kryesor, vetëm nga zyra nisëse. Autoritetet doganore në të tilla raste regjistrojnë detajet e nevojshme në të gjitha kopjet e dokumentit T1.

5. Afati kohor që zyra nisëse përcakton për paraqitjen e mallrave pranë zyrës së destinacionit, nuk lejohet të ndryshohet nga zyra e destinacionit.

6. Kur mallrat paraqiten pranë zyrës së destinacionit pasi ka përfunduar afati kohor i përcaktuar nga zyra nisëse dhe ky afat nuk është zbatuar për shkak të rrethanave që i arsyetohen bindshëm zyrës së destinacionit dhe nuk janë për shkak të transportuesit ose përgjegjësit kryesor, konsiderohet se këta të fundit e kanë respektuar afatin kohor të caktuar.

#### *Neni 199*

1. Personi që paraqet një dokument tranziti pranë zyrës së destinacionit së bashku me dërgesën të cilës i referohet ky dokument, ka të drejtë të marrë një vërtetim, në qoftë se ai e kërkon një gjë të tillë.

2. Formulari i vërtetimit i cili lëshohet për të dëshmuar faktin që një dokument tranziti dhe dërgesa përkatëse janë paraqitur pranë zyrës së destinacionit, duhet të përputhet me modelin në Aneksin 18. Megjithatë, vërtetimi lidhur me dokumentin e tranzitit mund të bëhet sipas modelit të treguar në faqen e pasme të kopjes 5 të deklaratës T1.

3. Vërtetimi plotësohet paraprakisht nga personi i interesuar. Ai mund të përfshijë detaje të tjera që lidhen me ngarkesën, përjashtuar hapësirën e rezervuar për zyrën e destinacionit, por konfirmimi nga zyra e destinacionit është i vlefshëm vetëm për sa i përket detajeve të përfshira në atë hapësirë.

#### *Neni 200*

1. Garancia të cilës i referohet neni 117 (1) i Kodit është e vlefshme në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

2. Garancia mund të jetë globale, që mbulon disa operacine tranziti ose individuale që mbulon një operacion të vetëm tranziti.

3. Garancia mund të jepet individualisht ose solidarisht nga persona të tretë fizikë ose juridikë që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 210 të Kodit, ose mund të depozitohet në të holla në një zyrë dërguese. Zyra dërguese mund të lejojë që depozitimi në të holla të bëhet edhe në ndonjë zyrë tjetër doganore kur rrethanat e kërkojnë një gjë të tillë.

4. Dokumenti i garancisë do të jetë në përputhje me modelet e dhëna në :

- a) Aneksin 19 për rastet e garancisë globale,
- b) Aneksin 20 për rastet e garancisë individuale.

5. Kur dispozitat e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, rregulloret ose veprimet administrative, ose praktika të zakonshme e kërkojnë një gjë të tillë, autoritetet doganore mund të lejojnë që garancia të jetë në një model tjetër, me kusht që ajo të ketë të njëjtat efekte ligjore si modelet e përmendura në paragrafin 4.

#### *Neni 201*

1. Përdorimi i një garancie globale i jepet vetëm personave:

- a) të cilët janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë;
- b) të cilët janë përdorues të rregullt, si përgjegjës kryesor, për një periudhë 6 muajore ose për të cilët autoritetet doganore kanë bindjen se gëzojnë një gjendje të mirë financiare, e cila i lejon të përmbushin detyrimet e tyre; dhe
- c) të cilët nuk kanë kryer shkelje serioze ose të përsëritura të legjislacionit doganor ose tatimor.

2. Garancia globale duhet të depozitohet në një zyrë garancie.

3. Zyrë garancie është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4. Zyra e garancisë përcakton shumën e garancisë, pranon marrjen përsipër nga garantuesi dhe lëshon një autorizim i cili lejon përdoruesin kryesor të kryejë, brenda kufijve të shumave të garantuara, çfarëdo operacioni tranziti pavarësisht nga zyra nisëse.

5. Çdo person që ka marrë një autorizim, bashkë me këtë të fundit merr edhe një ose disa dokumenta garancie të përpiluara sipas formularit të modelin të paraqitur në Aneksin 21.

6. Çdo dokument T1 i referohet dokumentit të garancisë.

7. Zyra e garancisë shfuqizon autorizimin për përdorimin e një garancie globale në cdo rast kur nuk plotësohen më kushtet e parashikuara në paragrafin 1.

#### *Neni 202*

1. Shuma e garancisë globale caktohet në 100% të detyrimeve dhe të gjithë pagesave të tjera, me një minimum prej 1 500 000 Lekë, sipas paragrafit 4, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2.
2. Autoritetet doganore mund të caktojnë shumën e garancisë globale në të paktën 30% të detyrimeve dhe pagesave të tjera, me një minimum prej 1 500 000 Lekë, sipas dispozitave të paragrafit 4 me kusht që:
  - a) operatori brenda një periudhë dy vjecare rregullisht ka kryer operacione tranziti sipas sistemit të garancisë globale;
  - b) operatori nuk ka kryer asnjë shkelje serioze të detyrimeve të veta gjatë kësaj periudhe;
  - c) garancia e reduktuar mbulon të paktën shumën e detyrimeve doganore;
  - d) mallrat nuk janë listuar në Aneksin 22 dhe nuk përjashtohen nga garancia globale.
3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 2 nuk zbatohet nëse kushtet e përshkruara po aty, pushojnë së ekzistuari.
4. Zyra e garancisë kryen vlerësime cdo javë për:
  - a) dërgesat e kryra;
  - b) detyrimet dhe pagesat e tjera për t'u paguar duke marrë parasysh nivelin me të lartë të taksimit të zbatueshëm. Ky vlerësim duhet të bëhet në bazë të dokumentacionit tregtar dhe kontabël të personit në fjalë, lidhur me mallrat e transportuara gjatë vitit të mëparshëm, shuma që merret më pas pjesetohet në 52. Në rastet e kërkuarve për garanci globale, zyra e garancisë në bashkëpunim me personin e interesuar bën vlerësimin e sasisë, vlerës dhe detyrimeve që zbatohen mbi mallrat e transportuara në një periudhë të caktuar, bazuar në të dhëna të disponuara. Zyra e garancisë me extrapolim përcakton vlerën e përafërt të detyrimeve të zbatueshme për mallrat që duhet të transportohen gjate një jave.
5. Zyra e garancisë kryen gjithë rishikimet vjetore të shumës së garancisë globale, vecanërisht në bazë të informacionit nga zyra nisëse dhe nëse është e nevojshme rregullon shumën.

#### *Neni 203*

1. Si me iniciativë të Ministrit të Financave ashtu edhe me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm i Doganave, përdorimi i garancisë globale mund ndalohet përkohësisht, kur kjo bëhet për qëllim të mbulimit të operacioneve të tranzitit lidhur me mallrat të cilat gjykohet se paraqesin rritje të rrezikut për mashttrim.
2. Periudha maksimale gjatë së cilës ndalohet përdorimi i garancisë globale për mallrat mund të jetë 12 muaj, me përjashtim të rasteve kur Ministri i Financave vendos ta zgjasë këtë periudhë.

#### *Neni 204*

1. Me lëshimin e dokumentit të garancisë, ose në cdo kohë gjatë periudhës në të cilën është e vlefshme kjo çertifikatë, pergjegjesi kryesor në faqën e pasme të dokumentit dhe nën pergjegjesinë e tij duhet të caktojë personin ose personat e autorizuar të nenshkruajnë për llogari të tij deklaratat e tranzitit. Të dhenat e vecanta duhet të përfshijnë emrin dhe mbiemrin e cdo të autorizuarit, pasuar nga nenshkrimi i ketij te fundit. Cdo emerim i nje personi te autorizuar konfirmohet nga nënshkrimi i pergjegjesit kryesor. Pergjegjesi kryesor ka të drejtë që me dëshirën e tij të vendosë kryq mbi kutitë e papërdoruarat.
2. Pergjegjesi kryesor mund të fshijë në cdo kohë emrin e personit të autorizuar nga faqja e pasme e çertifikatës.

#### *Neni 205*

Çdo person i përmendur në faqën e pasme të dokumentit të garancisë që paraqitet në një zyrë nisëse duhet të jetë përfaqësues i autorizuar prej pergjegjesit kryesor.

#### *Neni 206*

Afati i vlefshmerisë së çertifikatës së garancise nuk duhet të kalojë dy vjet. Megjithatë, ky afat mund të zgjatet nga zyra e garancisë për një periudhë të mëtejshme që gjithsesi nuk i kalon 2 vjet.

#### *Neni 207*

Në qoftë se garancia është hequr, përgjegjësi kryesor është përgjegjës për kthimin në zyrën e garancisë të të gjithë çertifikatave të garancisë ende të vlefshme, të leshuara në emer të tij.

*Neni 208*

1. Një garanci individuale e paraqitur për një operacion të vetëm tranziti depozitohet në zyrën nisëse. Zyra nisëse fikson shumën e garancisë. Shuma duhet të mbulojë gjithë detyrimet dhe pagesat e tjera që lidhen me dërgesën.
2. Garancia të cilës i referohet paragrafi 1 mund të jetë depozitë me para në dorë në zyrën nisëse. Në këtë rast, shumata e derdhur kthehet kur dokumenti T1 mbyllet në zyrën nisëse.

*Neni 209*

1. Garantuesi clirohet nga detyrimet e tij të parashikuara në nenin 214(1) të Kodit dhe gjithashtu clirohet edhe nga detyrimet lidhur me afatin e skadimit prej 12 muajsh nga data e regjistrimit të deklarates T1, kur zyra doganore nisëse nuk e ka njoftuar mbi faktin që dokumenti T1 nuk është mbyllur. Kur brenda afatit të parashikuar në fjalinë e mësipërme, garantuesi është njoftuar nga autoritetet doganore mbi mos mbylljen e dokumentit T1, më tej ai njoftohet mbi faktin se atij do t'i kërkohet ose mund t'i kërkohet të paguaje shumat për të cilat detyrohet për këtë operacion tranziti. Ky njoftim duhet t'i shkojë garantuesit jo më vonë se 3 vjet pas datës së regjistrimit të deklarates T1. Kur nuk është bërë një njoftim i tillë përpara datës së skadimit të afatit kohor, garantuesi clirohet nga detyrimet e tij.
2. Garancia që mbulon operacionet e tranzitit nuk shkarkohet deri në fund të periudhës tre vjecare të përmendur më sipër ose deri në shlyerjen e detyrimeve dhe pagesave të tjera të zbatueshme. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme lidhur me shkeljet ose parregullsitë dhe vendosin sanksionet e duhura në përputhje me Kodin.

*Neni 210*

1. Për qëllim të lejimit të mosdhënies së garancisë për operacionet e tranzitit, detyrimi që merr përsipër personi i interesuar në përputhje me nenin 118(2)(e) të Kodit, hartohet sipas modelit të përshkruar në Aneksin 23.
2. Kur legjislacioni shqiptar në fuqi ose praktika të zakonshme e lejojnë një gjë të tillë, autoritetet doganore mund të pranojnë që detyrimet e marra përsipër nga personi i interesuar të permbushen në një menyrë të ndryshme, me kusht që të ketë fuqi të njëjtë detyruese me detyrimet e marra përsipër sic tregohet në modelin në fjalë.

*Neni 211*

1. Në përputhje me nenin 118(3) të Kodit, mosdhënia e garancisë nuk zbatohet për mallrat:
  - a) vlera totale e të cilave i kalon 1 000 000 Lekë për dergesë; ose
  - b) të cilat janë renditur në Aneksin 22 si mallra që sjellin rrezik të lartë.
2. Mosdhënia e cdo lloj garancie nuk zbatohet për rastet në të cilat nuk lejohet përdorimi i garancisë globale.

*Neni 212*

1. Kur nuk është dhënë garanci, ky fakt tregohet në deklaratën T1 të tranzitit.
2. Çertifika që lejon mosdhënien e garancisë duhet të jete në përputhje me modelin në Aneksin 24.
3. Sapo lëshohet çertifikata për mosdhënien e garancisë ose në cdo kohë tjetër gjatë së cilës ky dokument është i vlefshëm, përgjegjësi kryesor nën përgjegjësinë e tij në faqën e pasme të çertifikatës duhet të caktojë personin ose personat e autorizuar të nënshkruajnë deklaratën e tranzitit për llogari të tij. Të dhënat e veçanta duhet të përfshijnë emrin dhe mbiemrin e cdo personi të autorizuar, pasuar nga nënshkrimi i këtij të fundit. Cdo caktim i një personi të autorizuar duhet të konfirmohet nga nënshkrimi i përgjegjësit kryesor. Përgjegjësi kryesor ka të drejtë që me dëshirën e tij të vendosë kryq mbi kutitë e papërdoruar. Po kështu, ky i fundit mund të fshijë emrin e ndonjë personi të autorizuar që është shënuar në faqën e pasme të dokumentit.
4. Cdo person i përmendur në faqën e pasme të një çertifikate që lejon mosdhënien e garancisë i paraqitur në një zyrë nisëse do të konsiderohet përfaqësuesi i autorizuar i përgjegjësit kryesor.
5. Afati gjatë të cilit është i vlefshëm një çertifikatë që lejon mosdhënien e garancisë nuk

duhet të kalojë 2 vjet. Megjithatë, ky afat mund të zgjatet nga vetë autoritetet që vendosin mosdhënien e garancisë për një periudhë të mëtejshme që nuk i kalon 2 vjet.

6. Në qoftë se çertifikata për lejimin e mosdhënies së garancisë shfuqizohet, përgjegjësi kryesor është përgjegjës për kthimin menjëherë tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të të gjitha çertifikatave për lejimin e mosdhënies së garancisë të cilat i janë lëshuar atij dhe që janë ende të vlefshme.

#### *Neni 213*

1. Kur një dërgesë nuk është paraqitur ende në zyrën e destinacionit, zyra nisëse duhet të lajmërojë menjëherë përgjegjësin kryesor brenda 5 javëve që prej datës së regjistrimit të deklaratës së tranzitit. Megjithatë, e drejta për të bërë lajmërim parashkruhet pas 11 muajsh nga data e regjistrimit të deklaratës së tranzitit.

2. Lajmërimi të cilit i referohet paragrafi 1, duhet të tregojë vecanërisht kufirin kohor brenda të cilit duhet të paraqiten prova të mjaftueshme për autoritetet doganore mbi rregullsinë e operacioneve të tranzitit në zyrën nisëse. Ky kufi kohor nuk duhet të jetë më i gjatë se një muaj nga data e lajmerimit të cilit i referohet paragrafi 1. Në qoftë se nuk është paraqitur kjo provë deri në fund të kësaj periudhe, autoritetet doganore kompetente duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur detyrimet doganore dhe gjithë pagesat e tjera përkatëse.

#### *Neni 214*

Provat mbi rregullsinë e një operacioni tranziti paraqiten për aq sa konsiderohen të mjaftueshme për autoritetet doganore nëpërmjet:

- a) paraqitjes së një dokumenti doganor ose tregtar të vërtetuar nga autoritetet doganore, i cili dëshmon që mallrat në fjalë janë paraqitur në zyrën e destinacionit. Ky dokument duhet të përmbajë informacionin e mjaftueshëm për t'u dhënë mundësinë mallrave në fjalë të identifikohen; ose
- b) paraqitjes së një dokumenti doganor që i vendos mallrat nën një regjim doganor në një vend tjetër ose me anën e një kopjeje apo fotokopjeje të tij; kjo kopje ose fotokopje të vërtetohet si origjinale nga autoritetet e vetë vendit tjetër i interesuar. Dokumenti duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për të dhënë mundësi të identifikohen mallrat në fjalë.

#### *Neni 215*

Deklarata e tranzitit dhe dokumentat hartohen në gjuhën shqipe.

#### *Neni 216*

1. Letra e përdorur për listën e ngarkesës dhe për formularët e vërtetimit duhet të jetë e përshtatshme për qëllime shkrimi dhe duhet të peshojë të paktën 40 g/m<sup>2</sup>; fortësia e saj duhet të jetë e tillë që në përdorim normal nuk griset ose rrudhohet lehtë.

2. Letra e formularëve të përdorur për çertifikatën e garancisë dhe çertifikata për lejimin e mosdhënies së garancisë duhet të mos kenë brum mekanik druri dhe të peshojë të paktën 100 g/m<sup>2</sup>. Duhet të ketë një fushë me motive arabeskash në të dy faqët në mënyrë që të tregojë ndonjë falsifikim të mundshëm mekanik ose kimik. Kjo fushë duhet të jetë:

- a) e gjelbër për çertifikatat e garancisë;
- b) bojëqielli për çertifikatat e lejimit të mosdhënies së garancisë.

3. Letra e përmendur në paragrafet 1 dhe 2 duhet të jetë e bardhë, me përjashtim të listë ngarkesës, për të cilën zgjedhja e ngjyrës i lihet personit të interesuar.

#### *Neni 217*

Formularët duhet të kenë përmasat:

- a) 210 x 297 mm për listë ngarkesën. Tolerancat duhet të jetë të tilla që përmasat të mos shkurtohen më shumë se 5 mm dhe të mos zgjaten më shumë se 8 mm;
- b) 210 x 148 mm për dokumentin e garancisë dhe çertifikatën për mosdhënie garancie.

#### *Neni 218*

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për shtypjen ose për të marrë masat për shtypjen e çertifikatës së garancisë dhe e çertifikatave të lejimit të mosdhënies së garancisë. Çdo çertifikatë duhet të mbajë një numër rendor për qëllim identifikimi.

2. Formularët për çertifikatat e garancisë dhe çertifikatat e lejimit të mosdhënies së garancisë duhet të plotësohen me makinë shkrimi ose procese të tjera të ngjashme



mekanografike.

3. Listë ngarkesat dhe vërtetimet mund të plotësohen duke përdorur makinë shkrimi ose procese të tjera të ngjashme mekanografike, ose me shkrim dore të lexueshëm; në rastin e fundit ato duhet të plotësohen në shkronja të mëdha shtypi dhe me bojë.

4. Formularët nuk duhet të përmbajnë fshirje të tjera ose ndryshime. Korrigjimet duhet të bëhen duke vënë një kryq mbi fjalët e shkruara gabimisht dhe duke shtuar hollësitat e nevojshme. Korrigjimet duhet të firmosen nga personi që i kryen ato dhe të vërtetohen shprehimisht nga autoritetet doganore.

*Neni 219*

Regjimi i tranzitit nuk është i detyrueshëm për ato mallra jo shqiptare të cilat të transportuara në rrugë ajrore, ngarkohen ose ringarkohen në një aeroport në Republikën e Shqipërisë dhe destinacioni i tyre është një aeroport tjetër në Republikën e Shqipërisë.

*Neni 220*

Regjimi i tranzitit nuk është i detyrueshëm për mallra jo shqiptare të transportuara në rrugë detare, vetëm nëse ato janë ngarkuar ose transborduar në një port të Republikës së Shqipërisë dhe destinacioni i tyre është në një port tjetër i Republikës së Shqipërisë.

*Neni 221*

Regjimi i tranzitit nuk zbatohet kur mallrat të cilave u referohet neni 114(1) i Kodit, janë ngarkuar në një mjet lundrues në një port të vendosur në Republikën e Shqipërisë për t'u eksportuar drejt një vendi tjetër pa u shkarkuar ose transportuar më parë në një port tjetër të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

*Neni 222*

Për qëllim të përdorimit të *Carnet* ATA si dokument tranziti, "tranzit" do të thotë transporti i mallrave nga një zyrë doganore e vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në një zyrë doganore të vendosur brenda të njëjtit territor.

*Neni 223*

Kur gjatë transportit nga një pikë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në një tjetër, mallrat kalojnë nëpër territorin e një vendi të tretë, kontrollet dhe formalitetet që shoqërojnë procedurën TIR ose ATA kryhen në pikat ku mallrat largohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe ku ato hyjnë sërish në këtë territor.

*Neni 224*

Mallrat e transportuara nën *Carnet* TIR ose ATA brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, konsiderohen mallra jo shqiptare, përveç rasteve kur statusi i tyre shqiptar është caktuar në mënyrën e duhur.

*Neni 225*

1. Ky nën zbatohet pa rënë ndesh me dispozitat e veçanta të Konventave TIR dhe ATA lidhur me përgjegjësinë e shoqatave të garancive kur përdoret një *Carnet* TIR ose ATA.

2. Kur vërtetohet se gjatë ose në lidhje me një operacion transporti të kryer në kuadrin e *Carnet* TIR ose një operacioni tranziti të kryer në kuadrin e një *Carnet* ATA, kryhet një shkelje apo ndodh një parregullsi brenda Republikës së Shqipërisë, vjelja e detyrimeve doganore dhe pagesave të tjera që duhen paguar, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pavarësisht nga fillimi i çështjes penale.

3. Kur nuk është e mundur të përcaktohet në cilin territor është kryer shkelja apo parregullsia, kjo shkelje apo parregullsi konsiderohet të jetë kryer në Republikën e Shqipërisë, në rast se është zbuluar atje, përveç rasteve kur brenda afatit të përcaktuar në konventat TIR dhe ATA, paraqiten prova të mjaftueshme për autoritetet doganore mbi rregullsinë e operacionit, ose prova mbi vendin ku është kryer në fakt shkelja ose parregullsia. Kur nuk paraqiten prova të tilla dhe shkelja ose parregullsia në fjalë konsiderohet të jetë kryer në Republikën e Shqipërisë, detyrimet ose pagesat e tjera lidhur me mallrat objekt shqyrtimi, vilen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në përputhje me Kodin dhe aktet e tij nënligjore. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për të ndjekur shkeljet ose parregullsitë e rastit dhe të vendosin ndëshkime e duhura, në bazë të Kodit.

*Neni 226*

1. Kur gjendet se është kryer një shkelje ose parregullsi gjatë ose në lidhje me një operacion

transporti te kryer nen nje *Carnet* TIR ose nje operacion tranziti kryer nen një *Carnet* ATA, autoritetet doganore lajmerojne mbajtesin e *Carnet*it TIR ose ATA dhe shoqaten garantuese brenda afatit te parashikuar ne nenin 11(1) te Konventes TIR ose nenin 6(4) të Konventës ATA, sipas rastit.

2. Provat mbi rregullsinë e operacionit të kryer në kuadrin e *Carnet*it TIR ose nje *Carnet* ATA duhet te paraqiten brenda periudhës së parashikuar në nenin 11(2) te Konventes TIR ose nenit 7(1) dhe (2) te Konventes ATA, sipas rastit.

3. Provat e permendura ne paragrafin 2 paraqiten ne perputhje me kerkesat e autoriteteve doganore:

- a) nëpërmjet nje dokument doganor ose fletë *Carnet*i te vertetuar nga autoritetet doganore që deshmon se mallrat ne fjale jane paraqitur ne zyren e destinacionit. Ky dokument duhet te perfhije informacion për të mundesuar identifikimin e mallrave; ose
- b) nëpërmjet një dokumenti doganor që tregon vendosjen nën nje regjim doganor në një vend tjetër, ose një fotokopje apo kopje të tij; kopja ose fotokopja duhet te vertetohet si originale sipre organit që ka pranuar, nëshkruar dhe vulosur dokumentin origjinal, ashtu edhe prej autoriteteve të vendit tjetër në fjalë. Ky dokument duhet të përmbajë informacion që mundëson identifikimin e mallrave në fjalë; ose
- c) për qëllim të Konventes ATA, nepermjet provave te pershkruara ne nenin 8 te asaj Konvente.

#### *Neni 227*

Për qëllim të nenit 1(h) të Konventes TIR, “zyrë doganore në rrugë” do të thotë çdo zyrë doganore nepermjet te ciles nje mjet rrugor, bashkesi mjetesh ose konteiner sic perkufizohet ne Konventen TIR, importohet ose eksportohet prej territorit doganor te Republikës së Shqipërisë gjate kohes se veprimit te nje operacioni TIR.

#### *Neni 228*

Për qëllim të nenit 8 (4) te Konventes TIR, kur nje dergese hyn ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë ose niset nga një zyre doganore e vendosur ne territorin doganor te Republikës së Shqipërisë, shoqata garantuese është ose behet pergjegjese ndaj autoriteteve doganore deri ne piken ne te cilen dergesa largohet nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë ose deri ne zyren doganore te destinacionit ne këtë territor.

#### *Neni 229*

Kur Drejtori i Përgjithshem i Doganave vendos të përjashtojë një person prej procedurës TIR sipas nenit 38 të Konventës TIR, ky vendim zbatohet në të gjithë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Ky vendim zbatohet për gjithë *Carnet*et TIR të paraqitura në një zyrë doganore për pranim.

#### *Neni 230*

1. Kur një operacion TIR ka të bëjë me mallra që paraqësin rrezik të lartë për mashtrim, ose kur autoritetet doganore e konsiderojne te nevojshme, zyra nises/e hyrjes mund te caktojë një itinerar për dërgesat. Itinerari ndryshohet me kërkesë të mbajtësit të *Carnet*it TIR, vetëm prej autoriteteve doganore të nisjes/të hyrjes. Autoritetet doganore regjistrojnë gjithë hollësitë përkatëse në *Carnet* TIR. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për të ndjekur shkeljet ose parregullsitë e rastit dhe për të vendosur ndëshkimet e duhura sic parashikohet në Kod.

2. Në rastet e forcave madhore, transportuesi mund të mos ndjekë itinerarin e përcaktuar. Dërgesa dhe *Carnet* TIR duhet të paraqiten pa vonesë në zyrën më të afërt doganore. Autoritetet doganore duhet të informojne zyrën nisëse/të hyrjes pa vonesë dhe të regjistrojnë të gjithë hollësitë përkatëse në *Carnet*in TIR.

#### *Neni 231*

Kur autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë konstatojnë se ka lindur një borxh doganor, dergohet një kërkesë në adresë të shoqatës garantuese sa më shpejt që të jetë e mundur. Kur borxhi lind per shkak te faktit se mallrat e mbuluara nga *Carnet* ATA nuk jane riekportuar ose nuk u është caktuar një destinacion doganor brenda afatit te percaktuar nga Konventa ATA, kjo kërkesë dërgohet duke filluar prej 3 muaj pas dates se skadimit te *Carnet*it.

#### *Neni 232*

1. Shuma e detyrimeve doganore dhe detyrimeve që lindin për shkak të mos mbylljes së një *Carneti* ATA, përlogaritet nëpërmjet formularit të detyrimeve modeli i të cilit pasqyrohet në Aneksin 25, e të plotësuar në përputhje me udhëzimet bashkëngjitur. Formulari i detyrimeve mund të dërgohet më vonë sesa vetë padia, por jo më shumë se 3 muaj më pas dhe sidoqoftë jo më shumë se 6 muaj nga data në të cilën autoritetet doganore fillojnë procedurën e vjeljes.
2. Formulari i detyrimeve plotësohet në dy ose në 3 kopje, sipas nevojës. Kopja e parë bëhet për shoqatën garantuese përkatëse. Kopja e dytë mbahet në zyrën doganore lëshuese.